

**S T A T U T I**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**„GPL Advisor“ SH.P.K**

**EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI**

**Neni 1**  
**Themelimi**

Sot më 13 Qershor 2022

Themelohet Shoqeria tregtare “**GPL Advisor**” sh.p.k si shoqeri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarë” nga ortaket e meposhtem:

- 1- **Giampiero Latini** shtetas Italian, lindur në Rome (RM) , Itali, i datëlindjes 13.10.1956 banues në Sant' Antonio di Padova 43 , 00138 Rome, Itali, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues karte identiteti(Identy card) nr.CA39096DB.
- 2- **Paolo Giordano Orsini** shtetas Italian, lindur në Rome (RM) , Itali, i datëlindjes 01.06.1947 banues në Giusepe Rovani n.12 , 00138 Rome, Itali, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues pasaporte nr.YB4547947.

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarë dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

Kjo shoqeri fiton zotesinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, qëndër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqerisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

**Neni 2**  
**FORMA DHE EMERTIMI**

2.1 Shoqeria do të ketë formën e shoqerisë me pergjegjesi te kufizuar, për sa kohë asambleja e ortakeve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.

2.2.Emërtimi i shoqerisë është " **“GPL Advisor” sh.p.k.**

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k.

### **NENI 3 BAZA JURIDIKE**

4. Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

### **NENI 4 SELIA**

#### **5.Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë.**

Ne adresen: Rr.Kodra e Diellit, Pallati Reli, Kati i pare, Zyra Nr.3, Selite, Farke, Tirane, dhe mund te ndryshojë seline e saj me vendim të ortakeve.

### **NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

- - konsulencë, udhëzime dhe asistencë operative për kompanitë sektori privat dhe publik;
- - konsulencë menaxheriale dhe konsulencë menaxheriale: politika e strategjia dhe planifikimi i biznesit, organizimi, efikasiteti dhe kontrolli, menaxhimi i informacionit;
- - kriji i faqeve të internetit; kriji i profilit të kompanisë, trajnimi dhe mbështetja synon rritjen e mundësive për akses në kredi për kreditë e subvencionuara dhe mundësitë financiare në përgjithësi, nga kompanitë dhe individët;
- - konsulencë për menaxhimin e marketingut: analiza e formulimi i një strategjie marketingu, formulimi i politikat për shërbimin ndaj klientit, çmimet, kanalet reklamimi dhe shpërndarja;
- - konsulencë në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore: politika, praktikat dhe procedurat në fushën e burimeve njerëzore;
- - rekrutimi, shpërblimi, përsitimet, matja dhe vlerësimi-të performancës;
- - Konsulencë për menaxhimin e prodhimit: më e mirazbatimin e procedurave dhe sistemeve të prodhimit;
- - këshilla dhe ndihmë për marrjen e certifikimit veprime cilësore;

*He - dr*

- - këshilla për fazat e fillimit të një biznesi;
- - aktivitete këshilluese në fushat e listuara më sipër;
- Kompania mund të blejë, përdorë dhe transferojë patentë, markat tregtare dhe vepra të tjera të zguarsisë njerëzore, për të dhënë dhe për të marrë licencat e shfrytëzimit tregtar.
- Të kryej të gjitha transaksionet imobiliare, pasuri të paluajtshme, komerciale, duke përfshirë import-eksport, ndermjetesime financiare.

Kompania gjithashtu mund të kryejnë të gjitha transaksionet tregtare dhe financiare dhe të zbatojë të gjitha nismat që lidhen me arritjen e objektivave sociale, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që lidhen me pronën e luajtshme dhe të paluajtshme

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.

## **NENI 6 KOHËZGJATJA**

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe te pacaktuar, duke filluar nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

## **NENI 7 TERRITORI**

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjisacionin e vendeve përkatëse.

## **KAPITULLI III AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI**

### **NENI 8 FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT**

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

### **NENI 9 LIBRI I SHOQERISË**

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do te çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

**NENI 10**  
**KONFIDENCIALITETI**

10.1 Ortaket e shoqerise si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnje personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

**NENI 11**  
**DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT**

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxiren nga Shoqëria dhe janë të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët “Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “SH.P.K”, si dhe emrin e administratorit.

**NENI 12**  
**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRANSFERIMI I  
TYRE**

12.1 Kapitali themeltar i shoqerise do të jetë ne **Leke**, 2.000.000,00 (dy milione /00 lekë).

12.2 Kapitali themeltar është i ndarë në 2(dy) kuota.


12.3 Ky kapital themeltar i shoqerise është i zotuar nga Ortaket si me poshte

- 1- **Giampiero Latini** shtetas Italian, lindur në Rome (RM) , Itali, i datëlindjes 13.10.1956 banues në Sant'Antonio di Padova 43 , 00138 Rome, Itali, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues karte identiteti(Identy card) nr.CA39096DB, *zoterues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1.600.000,00 (njëmillion e gjashtëqin mijë /00) lekë* e barabrtë me 80% te kapitalit te shoqerisë. *Ortaku ka të drejtë të tjetersojë, të zmadhojë apo të paksojë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e percaktuara nga ligji*
- 2- **Paolo Giordano Orsini** shtetas Italian, lindur në Rome (RM) , Itali, i datëlindjes 01.06.1947 banues në Giusepe Rovani n.12 , 00138 Rome, Itali, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues pasaporte nr.YB4547947, *zoterues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 400.000,00 katerqind mijë /00) lekë* e barabrtë me 20% te kapitalit te shoqerisë. *Ortaku ka të drejtë të tjetersojë, të zmadhojë apo të paksojë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e percaktuara nga ligji*

3-

Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të behët në përputhje me nenet 72- 75 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

12.5 Kapitali fillestari i shoqërise nuk **është paguar**.



## Neni 13

### Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit

- Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të trasferueshme në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.
- Transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar si trashgimni ose brenda familjes personave perfittues do ti behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund te kete pesuarderi ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar te behen lehtesish te transferueshme.
- Ne raste mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve

Transferimi i kuotave te kapitalit themeltar te secilit ortak themelues, ne persona te tjere jo ortake te shoqerise do te behet vetem me miratimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast ortaku qe kerkon te largohet nga shoqueria, duhet te respektoje te drejten e parablerjes se kuotave nga ortaket themelues te shoqerise. Ne rast se kuotat e ortakut themelues jane te tilla qe kane një çmim tregu te ndryshueshem do te merret si çmim i pranuar çmimi me i larte i shitjes, çmim i konfirmuar me garanci oferte te verifikueshem nga pjesmarresit e Asamblese se shoqerise. Në rast vdekjeje të ndonje prej ortakëve te shoqerisë trashegimtarët e tij apo rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve, subjektet perfittues sipas ligjit kane të drejtë të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit te shoqerise ose për vazhdimin e veprimtarisë sipas parashikimeve ne ligj nepermjet trashegimise dhe pjesmarrjes se trashegimtareve ligjore ne shoqeri apo bashkepjessmarrjes nga ndarja e pasurise bashkeshortore.

Ortaket e kësaj shoqërie, mund të vendosë të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e sheh të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 te Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

### ORGANI DREJTUES ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

### NENI 14 *Asambleja e Ortakeve*

Secili aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e mbledhjes së aksionarëve dhe mund të ketë një numër votash të barabarta me aksionet e kapitalit të zotëruar.

Një anëtar mund të përfaqësohet në një mbledhje të përgjithshme në bazë të një delegimi nga një partner tjetër, bashkëshorti ose personi tjetër i caktuar prej tij, me kusht që të autorizohet nga një prokurë.

Asambleja e ortakeve perbehet nga mbledhja e 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise. Ajo mblidhet me kerkesen e Administratorit. Gjithashtu secili prej ortakeve ka te drejtë t'i paraqese Administratorit kerkese me shkrim per mbledhjen e asamblese te pergjithshme duke treguar ne te arsyet, objektivat dhe çeshtjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Ne rast se kërkesa refuzohet, ortaku kanë të drejtë te thërrase asamblënë dhe të caktojë çeshtjet e rendit të ditës.

Permbajtja dhe rendi i dites iu njoftohet ortakeve te pakten 7 dite perpara mbledhjes se Asamblese, ne rastin e shoqerise njoftimi iu behet te ditur te gjithe ortakeve themelues. Mbledhja quhet e vlefshme kur me një nga menyrat e percaktuar ne ligj, eshte bere njoftimi i ortakeve te shoqerise (pjesmarresve te themeluesve), me konfirmim shkresor duke percaktuar edhe rendin e dites se mbledhjes. Ne rast se pjesmarresit marrin pjese personalisht ata do te konsiderohen te njoftuar pavarsisht nese nuk ka konfirmim me shkrim. Pjesemarresi ne mbledhje mund te jete vete ose te perfaqeshet nga një tjeter person te caktuar me Prokure perfaqesimi, duke patur te shprehur objektin e mbledhjes ne mbledhjen e Asamblese.

Vendimet e asamblese te cilat merren me shumice te thjeshte do te jene te vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Vendimet te cilat merren me shumice te kualifikuar do te jene te vlefshme vetëm nëse jane te pranishem ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave. Do te meren me shumice te kualifikuar prej  $\frac{3}{4}$  te kuotave pjesmarese vendimet per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Te gjitha vendimet e tjera do te meren me shumice te thjeshte. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të Shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kzsaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë ;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e pzdorimit.
- m) Çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji.

### Neni 15

#### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Mbledhja e zakonshme e Asambleës së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortaket.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket sipas nenit 84 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

## NENI 16

### KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

**Asambleja e Ortakeve ka per kopetence :**

Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqerisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqerinë apo për sektorë të veçante të veprimtarisë.

- Te emeroje apo shkarkoje Administratorin e shoqerise, pronar ose jo pronar.
- Të jape ose jo pelqimin per caktimin e ekspertit kontabel nga Administratoret e shoqerise, i cili do te beje auditimin e vtit ushtrimor;
- Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqerisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj ;
- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizonit financiar të shoqerisë me ekspertë të caktuar prej saj ose te kerkuar nga çdo ortak ;
- Te jape ose jo miratimin per marrjen e çdo lloj huaje apo kredie bankare.
- Te jape ose jo miratimin per shtimin e kapitalit apo pakesimin e tij.
- Te vendose per miratimin ose jo te largimit te ortakut ne rast te shitjes se kuotave dhe zevendesimin e tij me një person tjeter.
- Komptenca te tjera që parashikohen ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

## ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 17

### ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

Kompania mund të administrohet nga administratori i vetëm ose administratorët e shumtë, të cilët mund të janë persona fizikë të emëruar brenda komunitetit ose jashtë këtij komuniteti.

Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqerisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë riemerimi. Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i një shoqërie tregëtare mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie.

Administratori të detyrohen të:

*Nez h.*

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera te parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqese raport te ortaku i vetëm apo të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë te zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqerise është :

1-Znj. Alma Haruni madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr.karte Identiteti nr.032329862 lindur ne Lushnje, me 05.12.1991 dhe banues ne, Tirane, me afat emërimi për 5 vjet me të drejtë riemërimi.

### **LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI , DIVIDENTET NENI 18 LIBRAT E SHOQËRISË**

Shoqëria është e detyruar të mbajë përvèç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjera.

### **NENI 19 BILANCI**

Viti finanziar fillon ne 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.

**NENI 20  
DIVIDENTET**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe duke theksuar ekzistencën e fitimeve, mbledhja e aksionarëve përcakton pjesën e anëtarëve në formën e dividentëve mbi fitimet, në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit aksioner në kompani. Fitimet që do të shpërndahen midis anëtarëve në përpjesëtim me aksionet e kapitalit të kompanisë, përbëhen nga fitimi i vitit në të cilin janë zbritur shumat e rezervuara përfondin e domosdoshëm të aksioneve (5% të fitimeve) të secilit vit, derisa ky fond arrin vlerën 1/10 të kapitalit të kompanisë) dhe, nga ana tjetër, humbjet ose të ardhurat e mbajtura nga vitet e mëparshme zbriten ose rriten respektivisht.

**MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË  
NENI 21  
MBARIMI**

22.1 Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.


**NENI 22  
LIKUJDIMI**

23.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.  
Në fund të procesit te likujdimit, ortaket vendosin mbi bilancin përfundimtar finanziar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit. Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

**MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT  
NENI 23  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare, pasi te jete ezauruar mundesa e zgjidhjes se mosmarrëveshjes me mirkuptim midis ortakeve.

**NENI 24  
DISPOZITA E FUNDIT**



Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.


Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Ortaket e shoqerise.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë , me 13.06.2022

### ORTAKET

Giampiero Latini



Paolo Giordano Orsini

